Kur zyrtari është në funksionin e kryetarit a të nënkryetarit të bashkisë, komunës ose të këshillit të qarkut, të anëtarit të këshillit përkatës ose është zyrtar i nivelit të lartë drejtues të një njësie të



qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave privatë të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë, zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave, sipas rastit, me bashkinë, komunën ose këshillin e qarkut, ku zyrtari ushtron këto funksione. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë në kontratë është një institucion publik, në varësi të kësaj njësie (neni 21 pika 2 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e përcaktuara në nenin 21 pika 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin që në kuptim të këtij ligji janë **bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi, fëmijë në moshë madhorë, prindërit e zyrtarit të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es.**

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_, me cilësinë e përfaqësuesit të personit juridik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:

Jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të përcaktuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive si dhe të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Në përputhje me to deklaroj se asnjë zyrtar i përcaktuar në **Kreun III, Seksioni II** të Ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk zotëron interesa private në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me personin juridik që unë përfaqësoj.

Data e dorëzimit të deklaratës \_\_\_\_\_

**Emri, Mbiemri, Nënshkrimi**

\_\_\_\_\_

**Vula**

## Shtojca 7

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor ]

### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv),
- c) nuk është dënua për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënua me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

**Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.**

**Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 4.**

**Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.**

**Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:**

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*

b. *Deklarate për paraqitje oferte të pavaruar, sipas Shtojcës 1/1;*

c. *Deklaratën mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 4/1;*

ç *Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;*

d. *Deklaratën mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 6;*

dh. *Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

### **2.1.Për kapacitetin ligjor/profesional:**

Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit.

### **2.2.Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:**

2.3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të çertifikuara të bilanceve të 2(dy) viteve (2018, 2019) të paraqitur në autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky autoritet.

2.4 Kopje të deklaramit të xhiros vjetore gjatë 2 (dy) viteve ( 2018, 2019) lëshuar nga autoriteti përkatës, vlera mesatare e se ciles duhet te jete jo me e vogel se fondi limit përkatësisht 1.999.990 (një milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë) lekë pa tvsh.

2.5.Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2020 sipas përcaktimeve të parashikuara në ligjin nr.9632 datë 30.10.2006”Për sistemin e taksave vendore”i ndryshuar;

2.6.Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

### **2.7 Për kapacitetin teknik:**

#### **1. Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:**

Shërbime te ngjashme me objektin e prokurimit me vlerë jo më e vogël 40% e vlerës së përlloritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: 799.996 (shtatëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë pa tvsh , të kryera gjatë tri viteve të fundit( përlloritur nga data e zhvillimit të tenderit).

Për të vërtetuar përmbushjen e kriterit të sipërpërmendur Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

a)Kur shërbimi i ngjashem është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetoje duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar detyrimisht me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e sukseshëm të kësaj kontrate.

b)Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me subjekte private Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur faturat tatimore të shitjes të nënshkruar nga të dyja palët ku të shenohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.8.Operatori Ekonomik duhet të jetë i çertifikuar me ISO 9001:2015 për Menaxhimin e Cilësisë, (e vlefshme).(Ne rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO sipas zerave të shërbimeve që do të marrë persiper sipas akt-marreveshjes.)Në rast se certifikata është në gjuhë të huaj operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatën përkatëse (të përkthyer dhe të noterizuar).

2.9.Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin se ka të punësuar të paktën 3 specialistë/teknikë për kryerjen e këtij shërbimi. Për këto punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3(tre) muajt e fundit.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

**Shtojca 8**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor* ]

**SPECIFIKIMET TEKNIKE**

Specifikimi i Materialeve, Skicimet, parametrat teknik etj:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

**1. INFORMACION MBI INSTITUCIONIN**

---

Emri i Institucionit: Ujësjetës Kanalizime Tiranë sh.a.

Tel/Fax: 00 355 42240978

**2. QËLLIMI I SHËRBIMIT**

---

Qëllimi i këtij shërbimi, është mundësimi i një kontrate për *mirëmbajtjen e dhomes se serverave*:

- a) *Sistemit të Kondicionimit*
- b) *Panelet elektrike dhe sistemit BMS*
- c) *Sistemi Access Control dhe CCTV*
- d) *Shërbimi i Pastrimit*

në ambjentet e dhomes se serverave, ndërtuar pranë ambjenteve të UKT.

### **3. OBJEKTI I SHËRBIMIT**

---

Objekti kryesor i këtij shërbimi, është mirëmbajtja e Sistemit të Kondicionimit me fryrje nga poshte, e paneleve elektrike, e sistemit BMS, e sistemit CCTV, e sistemit Access Control, dhe Shërbimit të Pastrimit, me qëllim sigurimin e vazhdimësisë së punës në të gjithë komponentët dhe shërbimet e ofruara.

Komponentët kryesore janë:

- i. Mirëmbajtja e Sistemit të Kondicionimit
- ii. Mirëmbajtja e Sistemit të menaxhimit dhe monitorimit BMS
- iii. Mirëmbajtja e Paneleve Elektrik
- iv. Mirëmbajtja e Sistemit Access Control dhe CCTV
- v. Pastrimi i dhomes të serverave

### **4. AFATI I SHËRBIMIT**

---

Afati i shërbimit do të jetë për një periudhë 1 vjeçare.

### **5. FONDI I PARASHIKUAR I SHËRBIMIT**

---

Fondi i parashikuar është 1.999,990 Leke pa TVSH.

### **6. PLANIFIKIMI I BUXHETIT PËR NDËRTIMIN E SISTEMIT**

---

	<b>Pershkrimi</b>	<b>Njesia</b>	<b>Sasia</b>	<b>Cmim njesi</b>	<b>Total</b>
1	Mirembajtja e Dhomes se Serverave - Sistemi i kondicionimit -Sistemi i menaxhimit dhe monitorimit (BMS) - Panelet elektrike - Sistemi CCTV dhe Access Control -Sherbim pastrimi	Muaj	12		
		Totali pa TVSH			
		TVSH			
		Totali me TVSH			

## 7. PERSHKRIM I PERGJITHSHEM

Duke marre parasysh se sasia e Informacionit gjithmone edhe me shume ne rritje dhe qe dhoma e servera eshte pike me sensibel per ruatjen e tij, lind nevoja e mirembajtjes se dhomes se serverave .

Dhoma e serverave eshte ndertuar sipas standarteve bashkekohore dhe mundeson qe te gjithë shërbimet online të jenë të qendëruara e të integruara.

Me anën e këtij projekti kërkohet të arrihet mirëmbajtja për mirëfunksionimin e Dhomes se Serverave si dhe garantimi i kushteve teknike për ofrimin e shërbimeve të sigurta dhe online 24/7.

Sistemi elektrik ofron një furnizim të pandërprerë të energjisë për pajisjet elektronike dhe për sistemet e infrastrukturës dhe siguron një sistem redundant 2N brenda dhomes. Dhoma e serverave merr furnizim me energji elektrike nga burimi kryesor i godines dhe lidhet në panelin elektrik respektivisht në dy automate të cilët konsiderohen si kryesore për dhomen e serverave. Nga këto automate furnizohen të gjitha ngarkesat që janë në rregjimin e rrjetit normal të furnizimit me energji (psh. kondicioneri, prizat e shërbimit, etj) si dhe UPS. Paneli elektrik përveç automateve mbrojtës të cilët janë të pajisur me kontakte për të parë statusin ON/OFF, ka të instaluar llamba sinjalizimi për prezencën e tensionit multimeter me komunikim për matjen e parametërve të energjisë elektrike të cilët janë integruar në BMS. Panelet elektrike janë të prodhuesit SCHNEIDER.


Panelet e tensionit të ulët janë të pajisur me automate që furnizojnë të gjithë pajisjet në dhomen e Serverave dhe panelet e shpërndarjes për CRAC, sistemet në rryme të dobët e të tjera.

Shpërndarja e energjisë elektrike realizohet nga kabllot LS0H. Janë instaluar disa rrjete kabllorë.

- Rrjeti kabllor i furnizimit me energji nga rrjeti
- Rrjeti kabllor i furnizimit me energji nga UPS
- Rrjeti kabllor i furnizimit me energji të pajisjeve dhe sistemeve elektronike dhe të sigurisë.

Sistemi ftohës është i rëndësishëm për besueshmërinë e Server Room-it. Çdo pjesë e pajisjeve që kërkon mirëmbajtje, riparim, apo zëvendësim për shkak të ekspozimit ndaj temperaturave, shkakton uljen e jetëgjatësisë dhe rritjen e kostove. Sistemi i instaluar është ai i teknologjisë me fryrje të ajrit të ftohtë nga poshtë. Me anë të këtij sistemi sigurohet një ambient i përshtatshëm për punën e pajisjeve elektronike 24/7. Pajisjet kanë opsionin për kontrollin e lageshtësisë. Sistemi do të mirëmbahet në dhomen e servera duke ruajtur konfigurimin e aksit të ngrohtë/ftohtë dhe duke mbajtur të lartë rendimentin e ftohjes. Kondicionerët e instaluar janë të prodhuesit SCHNEIDER.





Sistemet e tjera te dhomes se serverave, si sistemi i kontrollit te aksesit, sistemi CCTV, dhe sistemi i monitorimit dhe menaxhimit BMS, jane te nje rendesie te vecante edhe kerkojne mirembajtje periodike.

Sistemi i kontrollit te aksesit eshte i prodhuesit CDVI, me dy readera te instaluar (njeri brenda dhomes dhe tjetra jashte dhomes).

Sistemi CCTV eshte i prodhuesit Hikvision dhe Sistemi BMS eshte i prodhuesit SCHNEIDER, ne te cilin integrohen te gjithë sistemet e siperpermendur.

## 8. SHËRBIMET DHE KËRKESAT FUNKSIONALE

NR	PERSHKRIMI	Kontroll 1 Mujor	Kontroll 3 Mujor
1	Sistem Kondicionim – SCHNEIDER	X	
2	Sistemi Elektrik – Panelet elektrike SCHNEIDER		X
3	Sistemi BMS - SCHNEIDER	X	
4	Sistemi Akses Kontroll - CDVI		X
5	Sistemi CCTV		X

**MIREMBAJTJA PER SISTEMET E SIPERPERMENDURA, KONKRETISHT:**

Per te gjithë sistemet e pershkruara me poshte, do te kryhen te gjithë kontrollet periodike sipas manualeve te mirembajtjes. Kjo kontrate nuk do perfshije furnizimin me pjese kembim/konsumi.

**Sistemi Kondicionimit**

**PAJISJA E KONDICIONIMIT "DOËN FLOË" SCHNEIDER TDAR0722A+CAP1802 -Cooling capacity: 25.0kË - 400V/3+N/50HZ**

**Njesite ftohese te precizionit**

Lista e meposhtme paraqet operacionet qe duhet te ndermerren gjate mirembajtjes se zakonshme te pajisjeve kondicionuese te precizionit per dhomat e serverave:

**Paisjet e kondicionimit. (kontrolli periodik – sipas manualit te mirmbajtjes se pajisjes)**

- Shtrengimi i Kontakteve Elektrike ne te gjithë panelin perkates.
- Shtrengimi i Kontakteve Elektrike tek pajisja.
- Pastrimi nga pluhurat i panelit.
- Kontrolli i paisjeve te kontrollit, sinjalizuese dhe atyre automatike.

**Verifikime dhe sherbime te pergjithshme (kontrolli periodik – sipas manualit te mirmbajtjes se pajisjes)**

- Kontrolli per zhurma dhe vibrime jo normale
- Pastrimi i filtrave paraprak te ajrit prej materjali sintetik me ajer me presion ose uje te ngrohte dhe solucion pastrues
- Pastrimi i njesise se jashtme kondenserit
- Kontrolli i sensoreve te temperatures se ajrit dhe lageshtise
- Verifikim i linjes se shkarkimit te kondensatit
- Verifikim nese ka humbje/trjedhje ne rakorde dhe tubacione

- Verifikim i gjendjes se termoizolimit të tubacioneve
- Kontrolli i sasise se refrigerantit në sistem

**Kontrolli teknik i pergjithshem i kompresoreve (kontrolli periodik – sipas manualit të mirmbajtjes së pajisjes)**

- Kontroll I nivelit të vajit dhe I rrjedhjeve eventuale
- Kontroll për prani të aciditetit

**Kontrolli funksional i kompresoreve (kontrolli periodik – sipas manualit të mirmbajtjes së pajisjes)**

- Kontroll I kabllimeve dhe kontaktoreve të fuqisë
- Kontroll I komponenteve mbrojtës të motorrit
- Kontroll I mbrojtjes termike të brendshme
- Kontroll I rezistencës elektrike
- Verifikim I gjendjes izoluese të kompresorit
- Testi në ngarkesë sipas shkalleve të kompresorit

**Kontrolli funksional i ventilatoreve (kontrolli periodik – sipas manualit të mirmbajtjes së pajisjes)**

- Kontroll I kontaktoreve të fuqisë
- Verifikim I balancimit të ventilatorit
- Verifikim I absorbimit elektrik të motorrit duke krahasuar me të dhënat e targetit
- Verifikim I gjendjes së izolatoreve elektrik të ventilatorit

**Kontrolli i njesise se lageshtimit (kontrolli periodik – sipas manualit të mirmbajtjes së pajisjes)**

- Verifikim I linjes së furnizimit me ujë të lageshtuesit

- Verifikim I linjes se shkarkimit te lageshtuesit
- Verifikim dhe pastrim I depozites se ujit te lageshtuesit
- Verifikim I funksionalitetit te rezistences ngrohese
- Verifikim I absorbimit elektrik te rezistences ngrohese duke krahasuar me te dhenat e targetit.

**Kontrolli i filtrit te gazit (kontrolli periodik – sipas manualit te mirmbajtjes se pajisjes)**

- Verifikim I temperaturave ne hyrje dhe ne dalje te filtrit

**Kontrolli I panelit elektrik dhe komandimit (kontrolli periodik – sipas manualit te mirmbajtjes se pajisjes)**

- Shtrengim I te gjitha lidhjeve elektrike (nese eshte e mundur)
- Pastrim nga pluhurat apo papastertite eventuale te panelit elektrik
- Verifikim I funksionimit korrekt te panelit te komandimit
- Verifikim I parametrave te punes
- Verifikim I komunikimit te pajisjes me sistemin BMS

**Kontrolli I komponenteve mates dhe sigurise (kontrolli periodik – sipas manualit te mirmbajtjes se pajisjes)**

- Verifikim I gjendjes funksionale te presostateve te presionit te larte
- Verifikim I gjendjes funksionale te presostateve te presionit te ulet
- Verifikim I gjendjes funksionale te transdutoreve te presionit te larte
- Verifikim I gjendjes funksionale te transdutoreve te presionit te ulet

Eshte e rëndesishme qe te gjitha hapat e listuara me siper te kryhen nga specialist te Certifikuar nga Prodhuesi i sistemit te kondicionimit SCHNEIDER.

## **Sistemi Elektrik**

Verifikimi teknik i gjendjes së sistemit elektrik, kryerja e pastrimeve të nevojshme, kontrolli i aksesoreve për fiksimin e kabllave dhe kanalave, kontrolli i etiketimeve, gjendjes së tokëzimeve, si dhe instalimin e materialeve, ne rast zëvendësimi. Kjo nënkupton vënien në punë të sistemit me të gjitha komponentët e nevojshëm. (pa përfshirë furnizim materialesh, pjesë konsumi, pjesë këmbimi etj).

Verifikimi teknik i gjendjes së pajisjeve elektrike, panele elektrike, PDU-ve (Prodhuesi, APC Schneider), kryerja e pastrimeve të nevojshme, kontrolli i aksesoreve për fiksimin e kabllave të tyre, si dhe instalimin e materialeve, ne rast zëvendësimi. Kjo nënkupton vënien në punë të sistemit me të gjitha komponentët e nevojshëm. (pa përfshirë furnizim materialesh).

### **Panelet elektrike (Prodhuesi: Schneider Electric)**

- Shtrengimi i kontakteve elektrike në të gjithë panelin (nese është e nevojshme).
- Pastrimi nga pluhurat
- Kontrolli i paisjeve të kontrollit, sinjalizuese dhe atyre automatike.

## **Ndricimi**

- Kontrolli dhe pastrimi.
- Shtrengim Kontaktesh.
- Zëvendësimi i llampave të djegura.
- Pastrimi i xhamit ose grilave të ndricuesit.

## **Sistemi i ndricimit të emergjencës**

- Kontrolli vizual i baterive dhe i kontakteve.
- Kontrolli i linjave.
- Kontrolli vizual i llampave.
- Testimi gjeneral i sistemit.

- Kontrolli i llampave

### **Sistemi BMS (Prodhuesi: SCHNEIDER)**

- Kontrolli teknik, pastrimi dhe riparimi i defekteve i çdo Moduli BMS duke përfshirë edhe sistemin e prezencës së ujit, si dhe elementeve përbërës të tyre.
- Kontrolli i funksionimit me teste reale.
- Pastrimi i Elementeve të Sistemit.
- Kontrolli i Erroreve dhe Eventeve të Softëarit.
- Rregullime dhe konfigurime perkatëse në rast defekti
- Zëvendësimi i materialeve nëse është e nevojshme dhe vënie në punë të sistemit pa përfshirë furnizimin e tyre

### **Sistemi CCTV (Prodhuesi: Hikvision)**

- Suport teknik për instalim dhe konfigurim të NVR. Kjo asistencë do të ofrohet sipas nevojave teknike të krijuara.
- Riparimi i defekteve në kamerat e brendshme, dhe zëvendësimi i materialeve nëse është e nevojshme, por pa përfshirë furnizimin e tyre.

### **Sistemi Access Control (Prodhuesi: CDVI)**

- Kontrolli i funksionimit të elementeve të sistemit të aksesit kontrollit.
- Kontrolli i Eventeve të Sistemit.
- Rregullimi i çdo defekti mekanik ose elektrik të derës
- Asistencë sipas nevojave teknike të krijuara.

### **Pastrimi**

Shërbime : Pastrimi në mënyrë profesionale i dhomës së serverave, dyshemese dhe hapësirës nën dysheme teknologjike

### **KUJDES**

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

### Shtojca 9

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në marrëveshjen kuadër]

#### **PLANIFIKIMI I KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

<input type="checkbox"/> Shërbim: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër _____		
<b>Kontrata Nr.</b>	<b>Titulli i Kontratës</b>	<b>Përshkrim i shkurtër i kontratës</b>
<b>01</b>	_____	_____
<b>02</b>	_____	_____
<b>03</b>	_____	_____
<b>...</b>	_____	_____

### Shtojca 10

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

#### **SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT**

Shërbimi që kërkohet:

### Shtojca 11

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

#### **TERMAT E REFERENCËS**

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:



Detyrat:

Sherbimet:

**Vendi i kryerjes së shërbimeve:**

Shpërndarja:

Vendi i kryerjes së shërbimeve:

## **Shtojca 12**

*[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]*

### **NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR<sup>3</sup>**

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

---

<sup>3</sup> Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore.

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s’kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme :

---

---

---

---

---

---

---

---

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt  
< Emri >

### Shtojca 13

[ Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor ]

### FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët  oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [\_\_\_\_\_] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një

vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

[Titullari i autoritetit kontraktor]

## Shtojca 14

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër ]

### FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_

\* \* \*

Procedura e prokurimit: \_\_\_\_\_

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:  oferta ekonomikisht më e favorshme  çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatorën e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*  
Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*  
2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_/Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_/Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

Etj. \_\_\_\_\_

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*], brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_  
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

**[Titullari i autoritetit kontraktor]**

**Shtojca 15.**

**KUSHTET E PËRGJITHSHME  
Shërbimet –Kërkesë për propozim**

**Neni 1: Qëllimi**

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e shërbimeve të prokuruarra me anë të procedurës kërkesë për propozim.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë, gjithashtu, Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

**Neni 2: Përkufizime**

- 2.1 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjijtjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.

- 2.3 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Shërbimet që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.4 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen shërbimin. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate shet Shërbimet.
- 2.7 “Shërbime” do të thotë të gjitha detyrat që do të kryhen nga Kontraktuesi sipas kontratës.
- 2.8 “Termat e References” shprehin objektin dhe qëllimin e kontratës, përcaktojnë detyrat, kërkesat, objektivat, shpërndarjen, vendin dhe dorëzimin e Shërbimeve që do të sigurohen.

### **Neni 3: Hartimi i Kontratës**

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në Dokumentat e Tenderit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

### **Neni 4 Praktikë Korruptive, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve**

- 4.1 Autoriteti Kontraktues mund t’i kërkojë Gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose njësi që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktues të inspektojë llogaritë dhe procesverbalet që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktues.

### **Neni 5 Informacioni Konfidencial**

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktuesi mund t’i japë nenkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktues deri në masën e kërkuar për nën-kontraktuesin në mënyrë që ai të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të



përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktuesin një dispozitë që premtion ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

## **Neni 6 Prona Intelektuale**

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë Kontrates do t'i përkasin Autoritetit Kontraktues i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Furnizuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoriteti Kontraktues të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose pregatitura nga Kontraktuesi gjatë kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktues.
- 6.3 Kontraktuesi duhet të sigurojë Autoritetin Kontraktues nga mospërgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose kryerja e Shërbimeve sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoriteti Kontraktues në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i gjërave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoriteti Kontraktues të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

## **Neni 7 Detyrimet e Përgjithshme të Kontraktuesit**

- 7.1 Kontraktuesi duhet t'i kryejë Shërbimet dhe përmbushi detyrimet e tij me të gjitha përpjekjet, eficiente dhe ekonomike në pajtim me teknikat dhe praktikat profesionale të pranuar në përgjithësi.
- 7.2 Kontraktuesi duhet të ndjekë praktika të shëndosha të biznesit dhe të përdorë teknologji të avancuar dhe të përshtatshme si dhe metoda të sigurta.
- 7.3 Në se kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të veprojë gjithmonë si një këshillues besnik i Autoriteti Kontraktues, në pajtim me rregullat dhe kodin e sjelljes të profesionit të tij dhe duhet që të mbështesi dhe ruajë gjithmonë interesin publik.
- 7.4 Në se kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të ushtrojë kujdes të plotë në mardhëniet me palët e treta duke përfshirë median dhe nuk duhet të marrë pjesë në veprime që janë jashtë kompetencës së tij në përfaqsimin e Autoritetit Kontraktues.

## **Neni 8 Detyrimet e Veçanta të Kontraktuesit**

- 8.1 Kontraktuesi duhet të kryejë të gjitha Shërbimet siç specifikohet tek Termat e References.
- 8.2 Kontraktuesi duhet t'i paraqesë Autoritetit Kontraktues të gjitha shërbimet, në sasi të përcaktuara, siç kërkohen nga kontrata duke përfshirë, por jo të kufizuara nga, të gjitha raportet, dokumentat, studimet, skicimet dhe planimetritë.
- 8.3 Kontraktuesi duhet të sigurojë raportet e lidhura me zbatimin e Shërbimeve siç kërkohet në kontratë.

#### **Neni 9 Specifikime dhe Skicime**

- 9.1 Në se kontrata kërkon shërbime skicimi, Kontraktuesi duhet të pregatisi të gjitha specifikimet dhe skicimet duke përdorur sisteme të pranura dhe të njohura në përgjithsi të pranueshme për Autoritetin Kontraktues dhe të marri parasysh standartet më të fundit.
- 9.2 Nëse kontrata kërkon shërbime skicimi, Kontraktuesi duhet të sigurojë se të gjitha specifikimet, skicimet dhe kërkesat e tjera janë përgatitur në bazë asnjënjëse përpara i përket nxitjes së konkurrencës në prokurimin e objekteve të skicimit.

#### **Neni 10 Lejet dhe Liçensat**

- 10.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për sigurimin e lejeve ose liçensave sipas kërkesave të Ligjeve të Republikës së Shqipërisë për kryerjen e Shërbimeve në këtë kontratë vec rastit kur palet bien dakord ndryshe.

#### **Neni 11 Heqja dhe Zëvendësimi i Personelit Kryesor**

